ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit:
Nr te prokurimit: **220-70001-0731-23-8855-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ri Tenderim - Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë në Spitali Përgjtihshëm Gjilan**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Krasniqi shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. Isa Boletini P+8/2 Ulpiana nr. 47.

(Adresa)

Prishtinë **10 000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

045/ 610003

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Gentiana Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Shpk.krasniqi@gmail.com

(Adresa elektronike)

12.01.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. Krasniqi Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi per kontrate i datës **23.08.2023.**
2. Pezullimi i Aktivitetit te prokurimit **12.09.2023.**
3. Dosja e tenderit e korrigjuar **04.09.2023.**
4. Dosja e tenderit e korrigjuar **08.09.2023.**
5. Dosja e tenderit e korrigjuar **06.01.2024.**
6. Dosja e tenderit e korrigjuar **09.01.2024.**
7. Vendimi i OSHP-se i datës **02.11.2023**
8. Sqarimi i datës **09.01.2024**
9. Kerkesa per rishqyrtim e dates **09.01.2024**
10. Vendimi i AK-se per refuzim te kërkesës per rishqyrtim i dates **10.01.2024.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**		

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x				**Jo**		

Procesverbali i hapjes eshte pranuar permes platformes se e-prokurimit

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 5.1 Kalkulimi i afateve kohore

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 27 Dosja e tenderit

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te Rregulloreve te KRPP-së.

Nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kenaqur me Kriteret e vendosura ne dosje te tenderit nga AK-së **SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN** te dates **23.08.2023** ne lidhje me aktivitetin e prokurimit**: Ri Tenderim - Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë në Spitali Përgjtihshëm Gjilan** me nr. te prokurimit: **220-70001-0731-23-8855-2-1-1** ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, ushtrojme kete ankese prane OSHP-se:

Për shkak se AK- **SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN:**

- ne mënyrë të kundërligjshme na ka refuzuar kërkesën tone per rishqyrtim edhe pse e ekmi dorëzuara brenda afateve kohore ashtu siç e përcakton LPP.

- AK ne dosje te tenderit ka vendosur kërkesa diskriminuese dhe te kundërligjshme.

Neve me datën 09.01.2024 kei parashtruar kerkese per rishqyrtim pranë AK-se por AK kundeligjeshem na ka refuzuar kërkesën tone per rishqyrtim me arsyetimin se kërkesa jone per rishqyrtim ka qene e jashtë afateshme dhe nëse i referohemi LPP-se konkretisht nenit 108/A ku thuhet:

Neni 108/A

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

3.Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

Nese i referohemi Rregullores se KRPP-se qe eshte thirr AK ne refuzimin e kërkesës tone per rishqyrtim atëherë thuhet:

Neni 60

Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni " kërkesat për rishqyrtim" brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).

Afati i fundit per dorëzimin e ofertave ka qene me datën 15.01.2024 dhe neve kërkesën per rishqyrtim e kemi parashtruar me datën 09.01.2024 edhe sikur ta kishim dorëzuar kërkesën tone per rishqyrtim me datën 10.01.2024 prape se prape jemi brenda afatit kohor sepse nëse i kalkulojmë ditët nga 15 qe eshte dita zero atëherë me 14 dita pare, me 13 dita e dyte me 12 dita e trete me 11 dita e katërt dhe me 10 dita e peste qe don te thotë se ne ditën e pese eshte dita e fundit per dorëzim te kërkesës per rishqyrtim pra se paku pese dite para afatit te fundit qe do te thotë se jemi se paku 5 dite para afatit te fundit pra nga data 10 e me tej pra 9, 8, 7, 6 etj.. qe don te thotë se e pakta eshte dita e peste apo minimumi, sepse afati i fundit eshte data 15.01.2024. Njejte nëse i kalkulojmë edhe afatet per dorëzim et kërkesës per rishqyrtim per dhënie psh. Nëse data 10 eshte dita zero data 11 eshte dita e pare, data 12 eshte dita e dyte, data 13 eshte dita e trete, data 14 eshte dita e 4, dhe data 15 eshte dita e 5, qe eshte afati i fundit per dorëzim te kërkesës per rishqyrtim, pra AK gabimisht i ka kalkuluar afatat kohore.

Neve ne kërkesën tone per rishqyrtim pranë AK-se kemi patur dy pretendime te cilat AK eshte dashur ti shqyrtoj dhe te na jap përgjigje, pretendimet tona jane:

1.

AK ka kërkuar një analizë financiare për punëtorët duke llogaritur të gjitha tatimet dhe taksat e aplikuara, pushimet vjetore të pasqyruara sipas Ligjit të Punës me nr.03/L-212 dhe ATK-se. Në pyetjen që i kemi parashtruar ne fazën e sqarimit te tenderit, përgjigjja e Autoritetit Kontraktues ka qene që t'i referohemi dosjes së tenderit, që do të thotë nuk ka dhënë përgjigje konform pyetjes së cilës ja kemi parashtruar, sepse, kërkesa e Autoritetit Kontraktues është që të respektohet Ligji i Punës me nr.03/L-212.

AK tek Kerkesa nr.5 ka kërkuar 45 punëtorë, një menaxher dhe një përgjegjës, pastaj tek kushtet e veçanta ka kërkuar 4 punëtorë që punojnë në ndërrimin e natës gjatë tërë muajit dhe se pagesat e tyre të paguhen sipas Ligjit të Punës me nr 03/L-212.

Këto AK i ka specifikuar qartë në dosjen e tenderit, mirëpo, në këtë specifikacion nuk ka specifikuar se sa punëtorë punojnë gjatë vikendeve dhe festave ashtu sic ka qenë në dosjen e tenderit para korrigjimit, tek kushtet e vecanta nderrimet e vikendeve dhe te festave janë gjithsejte 20 punetore, pse është larguar kjo kërkesë kur dihet mirë se në qendrat spitalore punohet 7 ditë në javë gjithashtu edhe çdo operator ekonomik është i obliguar që te punoj pra te kryej shërbimet e pastrimit qe rrjedhimisht edhe ata punëtorë që punojnë gjatë vikendit dhe festave të ju paguhen shtesat sipas Ligjit te Punes nr 03/L-212:

Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:

2.1. 20 % në orë për kujdestari;

2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;

2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;

2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe

2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.

(Shih Specifikacionin e Dosjes së Tenderit të QKUK-së, Aneksi nr.1, specifikimet teknike të detyrueshme, fq.19, tabela nr.3, punëtorët për punë shtesë në vikende dhe festa, sepse në mënyrë të qartë i ka specifikuar se sa punëtorë duhet të punojnë vikendeve dhe festave) dhe se është vetë kërkesë e Autoritetit Kontraktues që të respektohet Ligji i Punës.

AK ka krijuar konfuzitet me këto kërkesa dhe neve kemi probleme dhe huti ne përpilimin e çmimeve pasi qe këto kërkesa te AK-se jane te pa qarta dhe me dy kuptime ku AK duhet qarte dhe sakte ta formuloj kërkesën qe te mos leje hapesire per manipulime me çmime ne te ardhmen .

AK këto kërkesa i ka vendosur si kritere te përzgjedhjes dhe konform Rregullores 01-2022 te KRPP-se me konkretisht neni 25.5 thuhet se: *"Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit"*,

Pra me këto kritere do te behet edhe vlerësimi i tenderit dhe AK këto kritere duhet si vendos qarte dhe sakte.

2.

AK tek kërkesa dhe evidenca nr.5 ka kërkuar që të deklarohemi për pranimin e 45 punëtorëve në punë, pastaj tek kërkesa 15.1, pika 6, keni kërkuar që operatori ekonomik fitues është i obliguar që ti mbajë në punë punëtorët aktual të cilët janë duke punuar, ku numri i tyre është 45.

Pyetja ka qene se, a jemi të obliguar të marrim në punë të gjithë punëtorët të cilët kanë punuar më parë?

Pergjigja e Autoritetit Kontraktues ka qene se OE fitues është i obliguar që t'i punësojë 45 punetore siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe kërkohet t'i referohen dosjes se tenderit.

Kjo kërkesë është diskriminuese sipas neni 7 LPP-së pasi që AK nuk ka të drejtë të obligoj (imponoj) OE marrjen e këtyre punëtorëve. Pra, edhe kjo kërkesë është e pa nevojshme dhe duhet të largohet. Sipas vendimit të OSHP-së me numër 848-23 kjo kërkesë është diskriminuese dhe si e tillë duhet të largohet nga kriteret.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP që ta aprovoj ankesen tone si te bazuar ta detyroj AK-ne qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi lidhur me kete laktivitet te prokurimit dhe te nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: Krasniqi shpk ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Ri Tenderim - Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë në Spitali Përgjtihshëm Gjilan me nr. te prokurimit: 220-70001-0731-23-8855-2-1-1 te iniciuar nga AK- SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN,

OBLIGOHET AK që ti beje ndryshimet ne dosje te tenderit dhe ti Përmirësoj kriteret e përzgjedhje per aktivitetin e prokurimit: Ri Tenderim - Shërbimet e pastrimit të brendshëm dhe sanitarisë në Spitali Përgjtihshëm Gjilan me nr. te prokurimit: 220-70001-0731-23-8855-2-1-1 te iniciuar nga AK-SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet per sigurimin e Ofertes, Shpenzimet e Avokatisë si ne pergaditjen e kerkesave per rishqyrtim ashtu edhe per pergaditjen e ankeses. Dëmi refletkon në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*